

VENDIM
Nr. 64, datë 3.2.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.58, DATË 21.1.2015, “PËR TRAJTIMIN E DISA FAMILJEVE QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME SUPERSTRADËN FIER-VLORË”, ME PROGRAME SOCIALE TË STREHIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 30 e 33, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit nr. 58, datë 21.1.2015, ndryshohet si më poshtë vijon:
Fjalët “...përfitojnë nga programi social i strehimit pagesën e qirasë për një periudhë dy vjeçare...”, zëvendësohen me “...përfitojnë nga programi social i strehimit pagesën e qirasë për një periudhë trevjeçare...”.
2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi